

Më<sup>si</sup>  
Dana

31-10-2017

PKR. nr.33/17

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËR KRIME**

**TË RËNDA**, me Kryetarin e trupit gjyques Musa Konxeli me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Bytyqi Rexhepi, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDAKTUE], për shkak të veprës penale "mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" nga neni 374 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/I. nr. 12/17 e datës 28.02.2017, pas mbajtjes së shqyrimit fillestar publik me datë 19.05.2017, në praninë e përfaqësuesit të aktakuzës – Prokurorit të Shtetit Rasim Maloku dhe të pandehurit, të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri [REDAKTUE] nga fshati [REDAKTUE] K. [REDAKTUE], nga i ati [REDAKTUE] dhe e ëma [REDAKTUE], e gjinisë [REDAKTUE], i lindur më [REDAKTUE] në fshatin [REDAKTUE] K. [REDAKTUE], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i ve, baba i 18 fëmijëve, pensionist shkrim lexim dinë pjesërisht, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal [REDAKTUE]

**ËSHTË FAJTOR**

nga data e papërcaktuar deri më datën 15.01.2017, rrëth orës 14.00 i pandehuri në Stacionin Policor në Kaçanik ka lajmëruar se i është vjedhur pushka e gjuetisë por i njëjtë posedon edhe dy pushkë të tjera në shtëpinë e tij në lagjen e [REDAKTUE] në [REDAKTUE], të cilat pushkë janë AM-48 me numër 8x57JS 6389 prodhim Jugosllav ndërsa tjetra e prodhimit turk e tipit SEMI me numër DK 102446 si dhe tre fishekë të kalibrit të kalibrit 12 mm me leje të afatit të skaduar revole ku i pandehuri ka mbajtur në pronësi, kontroll në mënyrë të paautorizuar në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm të armëve të cilat pushkë janë konfiskuar nga ana e policisë,

me të cilën ka kryer veprën penale "mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë nenit 374 par.1 dhe neneve 7, 8, 9, 17, 21, 41, 73, 74 85  
dhe 86 të KPRK-ës, dhe nenit 498 dhe 365 të KPPK-ës, të pandehurit i shqipton:

### VËREJTJE GJYQËSORE

Konform nenit 374 par. 3 të KPRK-së, konfiskohen në mënyrë të përhershme pushkët e tipit AM-48 me numër 8x57JS 6389 prodhim Jugosllav ndërsa tjetra e prodhimit turk e tipit SEMI me numër DK 102446 si dhe tre fishekë të kalibrit të kalibrit 12 mm.

Konform nenit 453 par.4 te KPPRK-se, I pandehuri [REDACTED] lirohet nga detyrimi i kompensimit te shpenzimeve te procedurës penale, meqenëse I pandehuri ka gjendjen e dobët ekonomike dhe do te rrezikohej gjendja materiale e të pandehurit ose te personave që ai detyrohet ti mbështes.

### A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti Për Krime të Rënda, me aktakuzën e evidentuar PP/I. nr. 12/17 e datës 28.02.2017, ka akuzuar [REDACTED] për shkak të veprës penale "mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve " nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj aktakuze caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 19 maj 2017, në të cilin shqyrtim gjyqësor Prokurori i Shtetit mbeti në tersi pranë aktakuzës dhe i propozoj gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor dhe të shqiptoj një dënim sipas ligjit, ndërsa në këtë shqyrtim i akuzuari u deklarua fajtor për veprën për të cilën e ngarkon akuza.

Prokurori i shtetit Rasim Maloku, me rastin e paraqitjes së mendimit të tij, ka propozuar që të pranohet pranimi i fajësisë për të akuzuarin.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPP-së dhe me këtë rast vlerësoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe

pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht deklaratat e dhëna nga i pandehuri, vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve i datës 15.01.2017 si dhe të shikohet fotografitë që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të çartë faktike apo ligjore.

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë, e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj Gjykata, konform nenit 248 par. 4 të KPP-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsy ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale "mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve " nga nen 374 par.1 të KPRK-së siç është përshkruar hollësishët në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 64 të KPK-ës dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale të kryer, rrethanat personale dhe si rrethanë posaçërisht lehtësuese faktin se i akuzuari më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin, ka pranuar fajësinë, është pensionist, kurse në rastin konkret nuk gjeti rrethanë rënduese pos që vlerësoi peshën konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me shqiptimin e vërejtjes gjyqësore, duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari ka bërë pranimin e fajësisë dhe ka shprehur pendim të thellë për këtë vepër të kryer, sjelljen e të akuzuarit në të kaluarën (se nuk ishte dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë më pare), sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, se shprehte pendim të thellë për këtë vepër të kryer, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimive i paraparë në nenin 41 të KPK-ës përkatësisht dënnimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm dhe në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit e që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjera nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

I akuzuari u njoftua se vepra e tillë përbën vepër të dëmshme dhe të rrezikshme penale dhe nëse e njëjtë kryen prapë vepër të tillë, gjykata do të shqiptoj sanksion më të rëndë penal.

Konform nenit 374 par. 3 të KPRK-së, konfiskohen në mënyrë të përhershme pushkët një e llojit AM-48 me numër 8x57JS 6389 prodhim Jugosllav ndërsa tjetra e prodhimit turk e tipit SEMI me numër DK 102446 si dhe tre fishekë të kalibrit të kalibrit 12 mm.

Konform nenit 453 par.4 te KPPRK-se, I pandehuri [REDACTED], lirohet nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale, meqenëse i pandehuri ka gjendjen e dobët ekonomike dhe do të rrezikohej gjendja materiale e të pandehurit ose të personave që ai detyrohet ti mbështes.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.


**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI PËR KRIME TË  
RËNDA PKR.nr. 33/17 datë 19.05.2017.**

B. profesionale,

Kryetari i trupit gjyques,

Mirlinda Bytyqi Rexhepi

Musa Konxheli



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Anksa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.